

# E drejta për informim

Newsletter mujor mbi mbikëqyrjen e zbatimit të Ligjit për të Drejtën e Informimit

Newsletter është publikim i Zyrës së Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale

## Fokusi i muajit

**Zyra e Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale zgjidhet organizator i Konferencës së XV Ndërkombëtare të Komisionerëve për të Drejtën e Informimit**

Zyra e Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale përzgjidhet si organizatore e edicionit të 15-të të Konferencës Ndërkombëtare të Komisionerëve të Informimit (*International Conference of Information Commissioners-ICIC*) që do të mbahet në Shqipëri në vitin 2024.

Me votim unanim, anëtarët e ICIC, miratuan kandidaturën e Shqipërisë gjatë punimeve të Sesionit të Mbyllur të Konferencës së 13-të e cila u zhvillua në Puebla (Meksikë).

Besimi për organizimin e këtij aktiviteti është një përgjegjësi për Zyrën e Komisionerit, për promovimin e kulturës së transparencës dhe mirëqeverisjes në Shqipëri dhe më gjerë në rajonin tonë. Nga ana tjetër, mbajtja e Konferencës së ICIC në 2024 është gjithashtu, një simbolikë e fortë për një vend ku po bëhen përpjekje për një shoqëri më të hapur, falë sinergjive të përbashkëta të autoritetit mbikëqyrës, organizatave të shoqërisë civile, mediave dhe publikut të gjerë.

Ekspierienca e përfituar në organizimin e takimeve madhore botërore, si në rastin e Konferencës Ndërkombëtare të Komisionerëve për Mbrojtjen e të Dhënave Personale, Tirana 2019, dëshmoi mundësitë dhe aftësitë e një autoriteti të vogël, por dinamik për të mirëpritur aktivitete ndërkombëtare. Konferenca e ICIC 2024 do të jetë kontribut jo vetëm për promovimin e vendit, mikpritjes së tij, por edhe angazhim për forcimin e zbatimit të një të drejte e lirie themelore dhe zgjerimin e transparencës së autoriteteve publike.

(Për më shumë informacion rreth Konferencës së 13-të të ICIC lexoni në fq. nr. 4)

**Përmbledhje mujore e vendimeve dhe rekomandimeve**

**Vendim Nr. 17 - Banka e Shqipërisë**

**Vendim Nr. 18 - Avokatura e Shtetit**

# Vendimmarrja e Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale

TRANSPARENCA E AUTORITETEVE  
PUBLIKE ËSHTË NJË NGA SHTYLLAT  
E MIRËQEVERISJES

VIZITONI [WWW.IDP.AL](http://WWW.IDP.AL)

## #informim #transparencë #vendim

Zyra e Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale, gjatë muajit qershor 2022, ka dhënë 2 vendime urdhërimi për vënien në dispozicion të dokumentacionit në zbatim të ligjit 119/2014 "Për të drejtën e informimit" (LDI).

Me anë të vendimit nr. 17 datë 28.06.2022, Zyra e Komisionerit ka vendosur pranimin e ankesës ndaj "Bankës së Shqipërisë", me objekt "Ankim ndaj refuzimit për dhënie informacioni dhe kopje të dokumenteve zyrtare".

Kërkuesi ka kërkuar informacion lidhur me Vendimin nr. 16, datë 03.10.2018 të Këshillit Kombëtar të Territorit në të cilin është vendosur miratimi i lejes së ndërtimit për objektin: "Ecurinë e punimeve për rikonstruksionin e ish-Hotel Dajtit, kostot e deritanishme, afatet për përfundimin e punimeve dhe emërtimin e kompanisë fituese që është tenderuar për të përfunduar rikonstruksionin e objektit".

Autoriteti Publik ka kthyer përgjigje duke cituar se: "Bazuar në procedurat dhe politikat e brendshme të cilat lidhen me administrimin, Banka e Shqipërisë nuk e ka të mundur pranimin e kërkesës. Informacioni i kërkuar është i një natyre sensitive dhe të dhënat në përmbajtjen e tij janë informacion jo publik, i klasifikuar "sekret bankar/profesional."

Pas përgjigjes së sipërcituar, me pretendimin se është cenuar në të drejtën për informim, ankuesja ka paraqitur ankim pranë Komisionerit, duke i kërkuar ushtrimin e kompetencave që i njej ligji për rastet e refuzimit të dhënies së informacionit.

Komisioneri pas shqyrtimit paraprak të ankesës, bazës ligjore dhe rrethanave të faktit të paraqitura në të, vlerësoi se ankesa përmbush kriteret formale ligjore, të përcaktuara në nenin 24 të LDI.

Në ndjekje të procedurës për shqyrtimin administrativ të çështjes, Komisioneri, kërkoi nga Autoriteti Publik, të rivlerësojë dhënien e informacionit/dokumentacionit të kërkuar në përputhje me vendimmarrjen e Komisionerit për raste të ngjashme.

Në vijim, Autoriteti Publik ka kthyer përgjigje duke bërë me dije se: "Qëndrimi i Bankës së Shqipërisë në lidhje me objektin e kërkesës për informacion mbetet i pandryshuar, pra është në përputhje me aktet ligjore e nënligjore që rregullojnë klasifikimin dhe dhënien e informacionit të klasifikuar në bankë".

Me qëllim marrjen e një vendimi të drejtë dhe objektiv Komisioneri vlerësoi zhvillimin e një seance dëgjimore me palët.

Gjatë seancës dëgjimore, ankuesja rikonfirmoi qëndrimin e reflektuar në ankesë. Gjithashtu, përfaqësuesit e Autoritetit Publik rikonfirmuan qëndrimin e reflektuar në aktet shkresore të trajtuara më sipër

Pas konsultimit të legjislacionit përkatës, parashtrimeve të paraqitura nga Autoriteti Publik dhe zhvillimit të seancës dëgjimore, Komisioneri vlerëson se argumentet e paraqitura nga Autoriteti Publik për mosvënien në dispozicion të dokumentacionit të kërkuar nuk qëndrojnë.

Gjatë procesit të hetimit administrativ, Autoriteti Publik nuk provoi në asnjë moment, se në cilën pikë të nenit 17 të LDI e mbështet qëndrimin e tij lidhur me mosvënien në dispozicion të dokumentacionit të kërkuar, pasi është ky nen, i cili parashikon mundësinë e kufizimit të të drejtës për informim, shkaqet dhe arsyet që mund të çojnë një autoritet publik për të kufizuar të drejtën për informim, si dhe rastet përjashtimore nga ky rregullim.

Në pikën 6 të këtij neni, parashikohet se: "...Autoriteti publik tregon qartë pjesët e dokumentacionit përkatës që janë refuzuar, si dhe në bazë të cilës pikë të këtij neni është bërë ky refuzim".

Bazuar në këtë parashikim, Autoriteti Publik duhet të kishte vlerësuar individualisht çdo pikë të kërkesës për informacion, duke provuar dhe argumentuar mbi cilën pikë të nenit 17 bazohet kufizimi i informacionit, vlerësim i cili nuk rezulton të jetë bërë.

Për rrjedhojë, Autoriteti Publik nuk mund të bazojë kufizimin e një të drejte kushtetuese, vetëm mbi argumentin se informacioni i kërkuar është i një natyre sensitive dhe të dhënat në përmbajtje të tij janë informacion jo publik, i klasifikuar "sekret bankar/profesional".

Në përfundim, Zyra e Komisionerit vendosi urdhërimin e autoritetit publik për vënien në dispozicion të informacionit të kërkuar duke respektuar kufizimet në përputhje me pikën 6, të nenit 17, të ligjit nr. 119/2014 "Për të drejtën e informimit". Për tu njohur me vendimin e plotë të Zyrës së Komisionerit klikoni në faqen zyrtare [www.idp.al](http://www.idp.al)

## “Dita e Transparencës” me Autoritetet Publike të Qarkut Berat

Në kuadër të “Ditëve të Transparencës”, Zyra e Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale, në bashkëpunim me ambasadën e Britanisë së Madhe, zhvilluan në Berat takimin e tretë të kësaj iniciative, me institucionet publike të këtij qarku. Garantimi i të drejtës për akses në informacionin/dokumentacionin publik nëpërmjet nxitjes së transparencës proaktive dhe llogaridhënies së Autoriteteve Publike përmirësojnë ndjeshëm edhe shërbimet për qytetarët.

Në këtë aktivitet morën pjesë Komisioneri, z. Besnik Dervishi, znj. Mia Marzouk, Zv/ambasador i Britanisë së Madhe, znj. Valbona Zylyftari, Prefekt i Qarkut, drejtues/përfaqësues të njëjësive të vetëqeverisjes vendore, të institucioneve të sistemit të drejtësisë, strukturave rajonale të institucioneve të varësisë dhe koordinatorët e tyre për të drejtën e informimit.



Gjatë takimit u vlerësua ecuria e përmbushjes së detyrimeve të ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit” nga këto institucione. Nga monitorimi dhe analiza e situatës, Zyra e Komisionerit ka konstatuar nevojë për një angazhim më të madh në përditësimin e vazhdueshëm të Programit të Transparencës dhe Regjistrin të Kërkesave dhe Përgjigjeve. Në takim u kërkua nga koordinatorët dinamikë për rritjen e cilësisë në procesin e trajtimit të kërkesave për informacion nga qytetarët apo grupet e interesit, si dhe bashkëpunim konstant me ta për forcimin e kulturës së transparencës.

Gjithashtu, gjatë ditës së Transparencës në Berat stafi i Zyrës së Komisionerit shpërndaui për qytetarët materiale ndërgjegjësuese në disa stenda informuese si dhe zhvilloi takime me përfaqësues të njëjësive të vetëqeverisjes vendore në lidhje me ushtrimin në praktikë të së drejtës për informim.



## “Aksesi në informacion, pjesëmarrja dhe përfshirja në epokën digjitale”, Konferenca e 13-të e ICIC



Në datat 22-24 qershor, u zhvillua në Meksikë edicioni i 13-të i Konferencës Ndërkombëtare të Komisionerëve të Informimit (International Conference of Information Commissioners-ICIC), nën organizimin e Autoritetit Federal për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale të këtij shteti (INAI).

Ky takim i përvitshëm është forumi kryesor në rang botëror për trajtimin e problematikave lidhur me nxitjen e transparencës, integritetit dhe llogaridhënies së autoriteteve publike. Tematika e aktivitetit ishte “Aksesi në informacion, pjesëmarrja dhe përfshirja në epokën digjitale”, ku punimet e tij u ndoqën në format hibrid (fizikisht/online) nga përfaqësues të autoriteteve anëtare, organizmave partnere, bota akademike, shoqëria civile, media, etj.

Sesioni i Mbyllur i ICIC u mbajt më datë 24 qershor, ku u diskutua mbi veprimtarinë përgjatë 12 muajve të kaluara dhe u miratua Raportin Vjetor si dhe u realizuan raportimet respektive të grupeve të punës apo rajonale mbi zhvillimet në këtë fushë. Zyra e Komisionerit është anëtare në dy nga Grupet e Punës, atë për promovimin e transparencës proaktive dhe mbi trajnimet. Dy autoritete të reja nga kontinenti afrikan iu bashkuan ICIC, Komisioni për Aksesin në Informacion i Bregut të Fildishtë dhe Institucioni i Avokatit të Popullit të Etiopisë, duke e çuar në 73 anëtarësinë e institucioneve kombëtare/rajonale në organizatë.

Sesioni i Hapur i mbajti punimet në datat 22-23 qershor, ku u trajtuan një sërë çështjesh dhe u zhvilluan diskutime për sfidat e informacionit publik dhe transparencës në raport me inteligjencën artificiale, cloud apo blockchain. Po ashtu, interes patën edhe trajtimi i temave në lidhje me aksesin në dokumentacionin publik, dezinformimin dhe lirinë e shtypit në epokën digjitale si dhe transparencën proaktive, si mjet efikas në promovimin e rritjen e hapjes së institucioneve. Njëkohësisht në këtë Konferencë, u mbajtën një sërë aktivitetesh paralele dhe seminare nga UNESCO, grupet ndërkombëtare të punës dhe rrjete të ndryshme rajonale.